



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:207723

Datë: 09.03.2020

Numri i dokumentit: 00884477

P.nr.998/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZA, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me procesmbajtësin-praktikantin Gent Mustafa, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.A, nga Fshati, Komuna Shtime, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/Inr.1593-3/2019 të dt.16.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit M.A me datën 06.03.2020, të njëjtën ditë shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.A, nga Fshati, Komuna Shtime, i lindur me datën, nga i ati H.... dhe e ëma T.... e gjinisë L....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i martuar, babë i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

SEPSE:

Sepse nga data 21 Qershor 2017 e deri më tani i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e paluajtshme të personit tjetër dhe atë 11 ari tokë, me numër të parcelës P-...në vendin e quajtur në Komunën e Shtimes, hapësirë kjo që nga i pandehuri është mbjellë me grurë edhe pse i dëmtuari H.S e kishte paralajmëruar që për këtë pronë posedon dokumentacionin e ligjshëm,-

- me të cilën kreu veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 85 dhe 86 të KPRK-së dhe neneve 498, 499 dhe 500 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Të akuzuarit **M.A.**, i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penale.

I dëmtuarit **H.S.**, me vendbanim në Fshatin ..., Komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Në bazë në nenin 453 par 4 të KPPRK-së të pandehurin **M.A.**, e ka liurat nga pagesa e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 Euro dhe taksën për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në shumë prej 30 Euro me që po të obligonte që të paguaj do të rrezikonte gjendjen material të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht bazuar në Kartelën e ndihmës sociale e Lëshuar nga Qendra për Punë Sociale-Shtime.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/Inr.1593-3/2019 të dt.16.09.2019, ka ngarkuar të akuzuarin **M.A.**, nga Fshati, Komuna Shtime, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datën 06.03.2020, me marrjen pejsë të prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit **M.A.**, kurse i dëmtuari është ftuar me ftesë të rregullt por nga fletë dërgesa për dorëzim personal në flete kthesë dorëzuesi me datën 26.02.2020 ka shkruar se pala **H.S.**, gjendet jashtë vendit në shtetin e Zvicres.

Edhe në shqyrtimin gjyqësor gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 parag.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së, pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohe mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari **M.A.** në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se është e vërtet se që nga viti 1988 deri para tri vite e kamë punuar pronën për të cilën akuzohet e cila ka qenë pronë një serbi por atë me marrëveshje me pronarin dhe me Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të

Pronës kemi lidhë marrëveshje mbi qiranë për pronë bujqësore ku dhe kamë paguar qiranë, por kamë pasë qëllim që ta blej, por pronari i nacionalitetit serb pa ditur unë i kishte shitur H.S nga fshati ... dhe unë prej momentit kur e ka blerë H... e kamë liruar pronën për të cilën akuzohem se e kamë uzurpuar, andaj nuk kamë patër për qëllim që ta uzurpoj por kamë pasur qëllim që ta blejë këtë pronë pasi e kamë punuar shumë vite dhe kufizohet me pronën time dhe për këtë në shqyrtimin fillestar nuk kam pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohem se për seancën e radhës do të siguroj prova për sqarim ku e njoftoj gjyqtarin dhe prokurorin e shtetit se kamë shkuar në Komunën e Shimes, në Drejtorinë për Kadastër dhe e kam nxjerrë gjendjen faktike të parcelës që akuzohem se e kamë uzurpuar dhe të parcelës sime ku parcela e ime evidentohet me nr. ..., sipërfaqe pre 10.58 / dhjetë ari e pesëdhjetë e tetë metra katror / kurse parcelën që e ka blerë H.S , vetëm magjia i ndan. Unë edhe sot që jam paraqitur në gjykatë kamë shkuar te shtëpia e H... që së bashku të paraqitemi në gjykatë por dera e shtëpisë ishte e mbyllur pasi është e vërtet se gjendet jashtë Kosovës në shtetin e Zvicrës, por me palën e dëmtuar nuk ka asgjë, të keqe dhe nuk do ta pengoj asnjëherë blerësin e për këtë që akuzohem nuk e kam ditur se është uzurpim e pasi akuzohem e ndiej veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Mbështetur në neni 326 paragrafi 2 të KPPRK-së ,gjykata në shqyrtimin e pranimi të fajësisë së të akuzuarit ka marrë edhe mendimin e prokurorit të shtetit, te mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që i akuzuari pranimin e fajësisë është e bazuar si në dispozitiv të aktit akuzues, dhe është në përputhje me nenin 248 të KPPRK-së.

Gjyqtari në vazhdim të shqyrtimin gjyqësor pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka vlerësuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 326 par.4 i KPPRK-së, pasi i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, fajin e ka pranuar vullnetarisht duke e mbështetur në provat dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit të cilat gjinden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë: në kopjen planeve të parcelave të uzurpuara, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës-Zyra Kadastrale në Shtime, në Kontratën për shitblerjen e pajtueshmërisë LRP.nr.2067/2017 Ref.nr.616/2017 e dt.21.06.2017, si dhe provat të tjera që gjinden në shkresat e kësaj lënde penale shqyrtimi gjyqësor vazhdon me fjalën përfundimtare të palëve.

Në shqyrtimin gjyqësor në fjalën përfundimtare prokurori i shteti Avdullah Abedini, ka mbetur në tërësi pran akuzës së ngritur nga ana e prokurorisë si dhe kualifikimit juridik për veprën penale e cila i vihet në barrë te akuzuarit, nga baza e pranimi të fajësisë nga i akuzuari i cili pranim gjene mbështetje të plotë edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ti shqiptoi sanksion penal të parapara me ligj përmes të cilit do të arrihet qëllimi ndëshkimor, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese të akuzuarit ti merr pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimin e fajësisë e ka bërë pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimi.

I akuzuari M.A në fjalën përfundimtare kërkon nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të mere për bazë të gjitha theksimet që i ka dhen me rastin e pranimit të fajësisë se nuk do të përsëris veprën penale të tillë apo të ngjashme, kërkon nga gjykata që ti shqiptim një dënim sa ma të lehtë pasi është hera e pare që ndeshet me ligjin, i moshuar me gjendje jo të mire ekonomike shfrytëzues i asistencës sociale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Gjykata pasi analizoj të gjitha faktet e kësaj çështje penale, provave që gjinden në shkresat e lëndë ka aplikuar dispozitat ligjore të neneve 85, 86 të KPRK-së dhe neneve 498, 499 dhe 500 të KPPK-së dhe të akuzuarit M.A i ka shqiptuar sanksionin penale vërejtje gjyqësore, duke pas parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën e kryer e në rastin konkret pasi i pandehuri ka deklaruar se pronën për të cilën akuzohet e ka liruar në mënyrë vullnetare dhe ka premtuar se pronarin e saj në të ardhmen asnjëherë nuk do ta pengon gjykata mendon se për rastin konkret ky sanksion penal është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit. Me shqiptimin e vërejtjes gjyqësore kryesit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse kryesi përsëri kryen veprime të tilla gjykata do ti shqiptoj sanksion ma të rëndë penal.

Konformë nenit 463 par.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin H.S, me vendbanim në Fshatin, Komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Bazuar në nenin 453 par 4 të KPPRK-së të pandehurin e ka liruar nga pagesa e shpenzimeve të paushallit gjyqësore dhe për taksën për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.998/2019, me datë 06.03.2020

Procesmbajtës-Praktikanti
Gent Mustafa

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.